



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.4, nenin 30 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Rregulloren Nr. 04/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (01/2014) për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve, si dhe Vendimit KGJK Nr. 288/2023 të datës 28 korrik 2023, shpall:

KONKURS
DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
GJYQTAR – tri (3) pozita

- **Një (1) pozitë për Kolegjet e Apelit si shkallë e dytë e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe**
- **Dy (2) pozita për shkallën e parë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme**

KRITERET – Të gjithë gjyqtarët e emëruar në Dhomën e Posaçme duhet të përmbushin të gjitha kushtet e përcaktuara në Ligjin për Gjykatat për gjyqtarët e Gjykatës Supreme. Me fokus të veçantë, gjyqtarët që shërbejnë në Dhomën e Posaçme duhet të kenë përvojë të dëshmuar në fushat në vijim:

- 7.1. të drejtat pronësore;
 - 7.2 të drejtat e njeriut, me theks të veçantë në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
 - 7.3. e drejta e punës dhe e falimentimit;
 - 7.4. e drejta tregtare, përfshirë këtu qeverisjen e korporatave, dhe e drejta e detyrimeve;
-
- për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, gjyqtari duhet të ketë së paku tetë (8) vite përvojë si gjyqtar;

TË DREJTË APLIKIMI:

- për Kolegjet e Apelit si shkallë e dytë e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme kanë të drejtë aplikimi të gjithë gjyqtarët nga shkalla e parë e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;
- për shkallën e parë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme kanë të drejtë aplikimi të gjithë gjyqtarët e gjykatave të cilët plotësojnë kushtet sipas kriterëve të konkursit.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Data e fillimit të aplikimi: 22 gusht 2023

Data e fundit të aplikimit: 5 shtator 2023

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit në:

Sekretariatit e KGJK-së, Rruga "Luan Haradinaj" nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Kandidatëve që aplikojnë për pozitën përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e-mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.